  4. Në rast vendimi për të rritur kapitalin aksionar përmes kontributeve të reja, e drejta për ta nënshkruar atë u takon ortakëve, në proporcion me kuotat që zotërojnë.
- Përveç rastit të përmendur në nenin 2482-ter kod. civ., ku u takon ortakëve e drejta për të parashikuar shprehimisht në vendimin e shtimit që, po njëjloj, mund të zbatohet edhe përmes ofrimit të aksioneve të reja palëve të treta; në këtë rast, u takon ortakëve që nuk kanë kontribuar në vendim e drejta për t'u tërhequr sipas nenit 2473 kod. civ.
5. Në rast pakësimi të kapitalit aksionar për shkak humbjesh, nuk ka nevojë të depozitohen paraprakisht pranë selisë së shoqërisë raporti dhe vërejtjet e parashikuara nga neni 2482-bis, pr.2, kod. civ.
  6. Në rastin e përmendur në nenin 2466, pr. 2, kod. civ., në mungesë ofertash blerëse, kuota mund të shitet në ankand.

### **Neni 6) FINANCIMET PËR ORTAKËT**

Financimet me të drejtë kthimi të shumës së derdhur mund t'i bëjnë ortakët, edhe pse jo në proporcion me kuotat që zotërojnë në kapitalin e shoqërisë. Ato duhen bërë në mënyrat dhe sipas kufizimeve të përcaktuara në ligjet në fuqi për sa i përket mbledhjes së kursimeve. Përveç nëse përcaktohet ndryshe, depozitimet që bëjnë ortakët në favor të shoqërisë duhet të konsiderohen të pafrytshme.

### **Neni 7) LETRA ME VLERË TË BORXHIT**





Në përputhje dhe në mënyrat e parashikuara në nenin 2483 kod. civ., shoqëria mund t'i lëshojë letra me vlerë të borxhit prurësit ose individit, me vendim të ortakëve të marrë me votën pro të atyre ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit aksionar.

#### **Neni 8) TRANSFERIMI I KUOTAVE TË PJESËMARRJES ME AKT MES TË GJALLËVE OSE PËR SHKAK VDEKJEJE**

Tjetërsimi i kuotave palëve të treta, ortakëve dhe jo ortakëve, me akt mes të gjallëve në çfarëdolloj cilësie, përvetësimi i kuotave "për shkak vdekjeje" dhe detyrimi i kuotave personave të tjerë që kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë, lejohen vetëm me miratim të organit administrativ të Shoqërisë. Ky miratim mund të jepet nga organi administrativ me kërkesën verbale të kërkuësve.

– Në mungesë të këtij miratimi, ortaku shitës, trashëgimtari apo përfaqësuesi i trashëgimtarëve, në rast se janë shumë, duhet t'i kërkojnë organit administrativ me letër rekomande, miratimin për tjetërsimin, duke specifikuar kuotat që do të transferohen, të dhënat personale të blerësve, çmimin që pretendohet për lëshimin e mundshëm. Organi administrativ brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja e letrës rekomande të lartpërmendur, duhet t'ia komunikojë vendimin e vet, edhe pa motivim, ortakut shitës, trashëgimtarit apo përfaqësuesit të trashëgimtarëve.

– Në rast se organi administrativ nuk jep miratimin, ortaku mund, ndërsa trashëgimtari ose përfaqësuesi i trashëgimtarëve duhet, t'ua ofrojnë kuotat për shitje ortakëve të tjerë në proporcion me kuotat e tyre përkatëse, duke i treguar në letrën rekomande çdo ortaku, çmimin e treguar nga organi administrativ dhe një afat kohor jo më të vogël se gjashtëdhjetë ditë për pranimin e propozimit. Në mungesë të një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë mes ortakut tjetërsues, trashëgimtarit apo përfaqësuesit të trashëgimtarëve dhe ortakëve të tjerë apo disa prej tyre brenda afatit kohor të lartpërmendur prej gjashtëdhjetë ditëve, çmimin e kuotave të ofruara duhet ta përcaktojë një Kolegj Vlerësues i emëruar në përputhje me nenin 23 të këtij statuti.

Kolegji Vlerësues do të vendosë çmimin e kuotave në lidhje me vlerën e tyre në treg në momentin e ofertës së shitjes dhe do t'i duhet ta japë vendimin, i formës së prerë, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga themelimi i tij. Shitblerja duhet të përfundojë brenda tridhjetë ditëve kalendarikë nga dita kur Kolegji i dërgon palëve letrën rekomande për komunikimin e çmimit të vendosur. Për kuotat e ofruara në shitje, që mund të mos jenë blerë nga ortakë të tjerë, i jepet e drejta një ose më shumë ortakëve që t'i blejnë në proporcion me kuotat e tyre përkatëse.

Nëse, edhe pasi është zbatuar sa më sipër ende nuk është ushtruar e drejta e blerjes, i takon Organit Administrativ që në tridhjetë ditët pasuese të tregojë një subjekt tjetër blerës në vend të atij që nuk u parapëlqye, mundësisht me çmimin e përcaktuar si më sipër nga Kolegji Vlerësues. Nëse edhe kjo mundësi nuk jep rezultat, ofruesi do të jetë plotësisht i lirë t'u shesë kuotat e veta palëve të treta. Në rast se organi administrativ nuk shfrytëzon të drejtën e përmendur në paragrafin më lart dhe ortaku propozues nuk është në gjendje të arrijë në transferimin e kuotës, ai vet ka të drejtën të tërhiqet.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe për transferime të të drejtave të opsioneve që vijnë nga rritja e kapitalit aksionar.

– Shoqëria nuk mund të shënojë në librin e Ortakëve transferime që nuk janë

[vula]  
[pullë takse]

[vula]  
[nënshkrimi]

[nënshkrimi]

[nënshkrimi]

ORDINARIA



kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë nen 8.

– Kufizimet për transferimin e kuotave në përputhje me këtë nen 8 nuk zbatohen:

- a) për lëshimin e kuotave me akt mes të gjallëve, mes bashkëshortësh dhe mes të afërmish të drejtpërdrejtë dhe të tjerë brenda linjës së dytë;
- b) për transferime për shkak vdekjeje, mes bashkëshortësh dhe mes të afërmish të drejtpërdrejtë dhe të tjerë brenda shkallës së dytë.

#### **Neni 9) TËRHEQJA**

1. Ka të drejtë të tërhiqet nga shoqëria, me të gjitha ose një pjesë të kuotave të veta në kapitalin aksionar, ortaku që nuk ka kontribuar në aprovimin e vendimeve që kanë lidhje me ndryshimin e objektit të shoqërisë, transformimin, shkrirjen e ndarjen e shoqërisë, revokimin e gjendjes likuiduese, transferimin e selisë jashtë shtetit, kryerjen e operacioneve që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë apo një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave që u janë dhënë ortakëve sipas nenit 2468, pr. 3, kod. civ, si dhe në rastet e parashikuara nga neni 8 të këtij statuti.

Nëse shoqëria i nënshtrohet aktivitetit drejtues e koordinues në përputhje me nenin 2497 e vijues të kod. civ., u takon ortakëve e drejta e tërheqjes në rastet e parashikuara nga neni 2497-quater kod. civ.

2. Ortaku që ka ndërmend të tërhiqet duhet t'ia komunikojë këtë organit administrativ përmes një letre rekomande të dërguar brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga regjistrimi në regjistrin e ndërmarrjeve ose, nëse nuk parashikohet, nga kopjimi në librin e vendimeve të ortakëve apo të administratorëve i vendimit që e përlligj ose nga njohja e faktit që e përlligj. Për këtë qëllim organi administrativ duhet t'u komunikojë menjëherë ortakëve faktet që mund të japin shkas për ushtrimin e tërheqjes.

3. Në letrën rekomande duhet të tregohen të dhënat personale të ortakut që tërhiqet, vendbanimi i zgjedhur nga tërheqësi për komunikimet lidhur me procedurën e vlerën nominale të kuotave të pjesëmarrjes për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes.

4. Tërheqja konsiderohet e ushtruar ditën kur letra rekomande mbërrin në selinë ligjore të shoqërisë.

5. Kuotat për të cilat është ushtruar e drejta e tërheqjes janë të patjetërsueshme.

6. Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar tashmë, është i pavlefshëm nëse brenda nëntëdhjetë ditëve nga ushtrimi i tërheqjes shoqëria revokon vendimin që e ligjëron ose nëse është lëshuar vendimi i shkrirjes së shoqërisë.

7. Likuidimi dhe rritja e vlerës së kuotave të ortakut të tërhequr ndodh në mënyrat dhe kriteret e parashikuara nga neni 2473, pr. 3 e 4, kod. civ.

#### **Neni 10) VENDIMET E ORTAKËVE - KOMPETENCAT DHE MËNYRAT**

1. Ortakët vendosin për çështjet që ligji dhe këto rregulla të funksionimit të shoqërisë u japin kompetencë, si edhe për argumente që një ose më shumë administratorë apo shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar paraqesin për miratimin e tyre.

2. Në çdo rast, për kompetencat e ortakëve janë rezervuar:

- a) miratimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve;
- b) emërimi i organit administrativ;







274  
275

- c) emërimi i mundshëm i kryetarëve dhe i presidentit të kolegjit sindikal ose i audituesit;
- d) ndryshimi i aktit themelues;
- e) vendimi për të kryer operacione që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave të ortakëve;
- f) përcaktimi i masave në përputhje me nenin 2482-bis;
- g) shkrirja para kohe e shoqërisë;
- h) emërimi i likuiduesve dhe kriteret e zhvillimit të likuidimit;
- i) revokimi i gjendjes së likuidimit;
- l) miratimi i propozimit të marrëveshjes mbrojtëse ose falimentuese;
- m) kërkesa për pranim në administratën e kontrolluar.

[vula]  
[pullë takse]

3. Me përjashtim të asaj që është parashikuar në paragrafin e parë të nenit vijues 11, ortakët mund t'i marrin vendimet, jo vetëm gjatë asambleve, por edhe përmes konsultimeve të shkruara ose miratimit të shprehur me shkrim.

### **Neni 11) VENDIMET E ORTAKËVE PËRMES VENDIMEVE TË ASAMBLESË**

1. Në rast të vendimeve që kanë si objekt çështjet e treguara në nenin pararendës 10, paragrafi 2, gjerat d) , e) , f) , g) , h) , i) , l) , m) , si edhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji ose nga këto rregulla për funksionimin e shoqërisë, ose kur e kërkojnë një apo më shumë administratorë apo një numër ortakësh që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar, vendimet e ortakëve duhet të merren përmes vendimeve të asamblesë.

[vula]  
[nënshkrimi]

2. Asamblenë e thërret organi administrativ ose shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar edhe jashtë komunës së selisë së shoqërisë, me kusht që të jetë në territorin e Bashkimit Evropian.

3. Asambleja thirret me njoftim dërguar ortakëve, administratorëve dhe kryetarëve, nëse janë emëruar, tetë ditë para ditës së caktuar për mbledhjen. Ky njoftim dërgohet me letër rekomande apo me çdo lloj tjetër mjeti të përshtatshëm që siguron provën e marrjes. Nëse dërgohet më vonë se tetë ditë, njoftimi duhet marrë të paktën pesë ditë para mbledhjes.

Në njoftimin e thirrjes duhen treguar dita, vendi, ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve për trajtim.

Në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë tjetër për një thirrje të dytë, në rast se mbledhja e parashikuar për thirrjen e parë të asamblesë nuk rezulton e themeluar ligjërisht.

[nënshkrimi]

4. Edhe pa një thirrje formale, asambleja quhet e themeluar rregullisht kur në të merr pjesë i tërë kapitali aksionar dhe të gjithë administratorët e kryetarët, nëse janë emëruar, janë të pranishëm ose të informuar dhe asnjë nuk kundërshton trajtimin e argumentit. Në rast se administratorët ose kryetarët, nëse janë emëruar, nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të lëshojnë një deklaratë të shkruar që do të ruhet në aktet e shoqërisë, ku të deklarojnë se janë informuar për mbledhjen.

5. Në asamble mund të marrin pjesë ortakët e shkruar në librin e ortakëve.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamble përmes një delegimi të shkruar që i dorëzohet të deleguarit edhe me faks ose me postë elektronike me firmë dixhitale.

6. Asamblenë e kryeson administratori unik, Presidenti i Këshillit Administrativ ose personi që kanë caktuar pjesëmarrësit, të cilët emërojnë edhe një sekretar

[nënshkrimi]







që e ndihmon. Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e themelimit të asamblesë, sigurohet për identitetin dhe ligjësinë e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e saj dhe sigurohet për rezultatet e votimeve.

7. Asambleja mund të zhvillohet edhe me pjesëmarrësit që ndodhen në disa vende, afër ose larg, të lidhur me audio e video, me kusht që të respektohet metoda kolegjiale dhe parimet e mirëbesimit dhe të trajtimit të barabartë të ortakëve. Në këtë rast është e nevojshme që: presidentit të asamblesë t'i lejohet, edhe me anë të zyrës së vet të presidencës, të sigurohet në mënyrë të qartë për identitetin dhe ligjësinë e pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë e të shpallë rezultatet e votimit; t'i lejohet subjektit që mban procesverbalin të perceptojë siç duhet ngjarjet e asamblesë që janë objekt të procesverbalit; t'u lejohet pjesëmarrësve që të marrin pjesë në kohë reale në diskutimin dhe në votimin e njëkohshëm për argumentet e rendit të ditës; të tregohen në njoftimin e thirrjes vendet audio/video të lidhura nga shoqëria, në të cilat pjesëmarrësit mund të shkojnë, duke qenë se mbledhja konsiderohet e zhvilluar aty ku janë të pranishëm presidenti dhe sekretari.

8. Vendimet e asamblesë vërtetohen me një procesverbal të hartuar pa vonesë dhe që e nënshkruajnë presidenti e sekretari. Kur e kërkon ligji dhe kur administratori unik apo këshilli administrativ e gjykojnë të përshtatshme, procesverbalin e harton noteri i zgjedhur nga personi që kryeson asamblenë. Procesverballi duhet të tregojë datën e asamblesë dhe, edhe bashkëngjitur, identitetin e pjesëmarrësve e të kapitalit të përfaqësuar nga secili; duhet të tregojë gjithashtu mënyrat dhe rezultatit e votimeve e duhet të lejohet, edhe bashkëngjitur, identifikimin e ortakëve me votë pro, abstenim ose kundër.

#### **Neni 12) VENDIMET E ORTAKËVE PËRMES KONSULTIMIT TË SHKRUAR**

1. Konsultimi i shkruar bëhet me iniciativën e një ose më shumë administratorëve apo të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar dhe përbëhet nga një propozim vendimi që duhet dërguar të gjithë ortakëve, me çfarëdo mjeti të përshtatshëm që siguron provën e marrjes. Propozimi duhet të tregojë qartë argumentin e konsultimit dhe çfarë nevojitet për të siguruar informacionin e duhur rreth argumenteve për t'u trajtuar, si edhe tekstin e saktë të vendimit që duhet marrë.

2. Ortakët kanë dhjetë ditë kohë për të dërguar përgjigjen që duhet nënshkruar në fund të dokumentit të marrë, përveç nëse propozimi tregon një afat tjetër, mjaft që të mos jetë më i vogël se pesë ditë dhe jo më i madh se tridhjetë ditë. Përgjigja duhet të përmbajë një miratim ose një mohim. Mungesa e përgjigjes nga ana e ortakëve brenda afatit të lartpërmendur konsiderohet votë kundër.

3. Organi administrativ duhet të mbledhë konsultimet e marra dhe t'u komunikojë rezultatit të gjithë ortakëve, administratorëve e kryetarëve, nëse janë emëruar, duke treguar:

ortakët me votë pro, kundër ose abstenim me kapitalin që përfaqëson secili;

- datën e marrjes së vendimit;

nëse e kërkojnë vetë ortakët, vërejtjet ose deklaratat e mundshme rreth argumentit të konsultimit.

4. Vendimet e ortakëve të marra sipas këtij neni duhen të kopjohen pa vonesë në librin e vendimeve të ortakëve.





Dokumenti që u dërgohet ortakëve me propozimin e vendimit dhe dokumentet që ata i kthejnë shoqërisë për të shprehur vullnetin e tyre, duhen ruajtur nga shoqëria. Të gjitha këto dokumente gjithashtu, mund të hartohen e të dërgohen elektronikisht, të pajisura me një firmë dixhitale.

### **Neni 13) VENDIMET E ORTAKËVE NË BAZË TË MIRATIMIT TË SHKRUAR**

1. Miratimi që shprehet me shkrim tregon çdo vendim të mundshëm të miratuar jashtë mbledhjes kolegjiale dhe që nuk ka rezultuar nga një konsultim paraprak i ortakëve dhe nga pranimi i një propozimi të paracaktuar për vendim sipas nenit të mëparshëm 12. Ky miratim është një deklaratë e dhënë nga çdo ortak që i referohet në mënyrë specifike dhe të qartë argumentit të vendimit, për të cilin ortaku që jep miratimin deklaron se është informuar sa duhet. Miratimet mund të dërgohen me anë të çfarëdo mjeti të përshtatshëm që siguron provën e marrjes.

2. Vendimi i ortakëve konsiderohet i marrë vetëm kur në shoqëri mbërrijnë, në format e lartreguara dhe brenda dhjetë ditëve nga marrja e komunikimit të parë, miratimet e shumë ortakëve që arrijnë kuorumin vendimor të parashikuar në nenin vijues 14.

3. Organi administrativ duhet të mbledhë miratimet e shkruara të marra dhe t'ua komunikojë rezultatin të gjithë ortakëve, administratorëve, kryetarëve e audituesit, nëse janë emëruar, duke treguar:

- ortakët me votë pro, kundër ose abstenim me kapitalin që përfaqëson secili;
- datën e marrjes së vendimit;
- nëse e kërkojnë vetë ortakët, vërejtjet ose deklaratat e mundshme rreth argumentit të konsultimit.

4. Vendimet e ortakëve të marra sipas këtij neni duhen të kopjohen pa vonesë në librin e vendimeve të ortakëve.

Dokumentet e mbërritura në shoqëri dhe që përmbajnë shprehjen e vullnetit të ortakëve duhet t'i ruajë shoqëria. Të gjitha këto dokumente gjithashtu, mund të hartohen e të dërgohen elektronikisht, të pajisura me një firmë dixhitale.

### **Neni 14) VENDIMET E ORTAKËVE - KUORUMI**

1. Asambleja mbledhet rregullisht me praninë e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën shumicën e kapitalit aksionar dhe vendos me shumicë absolute për kapitalin e përfaqësuar në asamble.

Në çdo rast vota i përket secilit ortak në proporcion me pjesëmarrjen e tij.

2. Vendimet e ortakëve përmes konsultimit të shkruar apo në bazë të miratimit të shprehur me shkrim miratohen me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën shumicën e kapitalit aksionar.


3. Merren me votë pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit aksionar vendimet:

- a) që kanë të bëjnë me ndryshimet e aktit themelues;
- b) që kanë lidhje me operacione që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë;
- c) që kanë lidhje me operacione që sjellin një ndryshim të rëndësishëm të drejtave të ortakëve;
- d) që kanë lidhje me transformimin e shoqërisë në shoqëri me partneritet, shkrirjen e ndarjen e shoqërisë dhe lëshimin e letrave me vlerë të borxhit, pa ndryshuar fakti që kërkohet megjithatë miratimi i ortakëve që me transformimin marrin përgjegjësinë e kufizuar.

[vula]  
[pullë takse]

[vula]  
[nënshkrimi]

[nënshkrimi]





4. Për të prezantuar, ndryshuar ose hequr të drejtat që i janë dhënë secilit ortak në përputhje me nenin 2468, pr.3, kod. civ., nevojitet miratimi i të gjithë ortakëve.

5. Në thirrjen e saj të dytë, asambleja vendos me shumicë absolute të të pranishmëve, pavarësisht nga pjesa e kapitalit që kanë ortakët e pranishëm në asamble. Bëhet përjashtim vetëm për vendimet e parashikuara në paragrafin 3 më lartë që duhen marrë me votë pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit aksionar.

6. Megjithatë nuk preken dispozitat e ligjit apo të këtyre rregullave të funksionimit të shoqërisë që, për vendime të veçanta, kërkojnë shumica të ndryshme specifike.

#### **Neni 15) ORGANI ADMINISTRATIV**

1. Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative;

a) nga një administrator unik;

b) nga një këshill administrativ i përbërë nga minimumi tre deri maksimumi nëntë anëtarë, sipas numrit të përcaktuar në aktin e emërimit;

c) nga dy ose më shumë administratorë me kompetenca më vete ose të përbashkëta;

edhe jo ortakë, sipas vendimit të asamblesë që, duke i zgjedhur, përcakton numrin dhe kohëzgjatjen e detyrës. Administratorët mund të rizgjidhen.

2. Me organ administrativ nënkuptohet administratori unik, këshilli administrativ ose të gjithë administratorët të cilëve u është besuar bashkërisht ose ndaras administrimi.

3. Emërimi i administratorëve dhe zgjedhja e sistemit të administrimit u takon ortakëve në përputhje me nenin 2479 kod. civ.

4. Administrimi i shoqërisë mund t'u besohet edhe subjekteve që nuk janë ortakë.

5. Nuk mund të emërohen administratorë dhe, nëse emërohen, humbasin detyrën ata që përmbushin kushtet që parashikon neni 2382 kod. civ.

6. Administratorët qëndrojnë në detyrë për periudhën e përcaktuar në aktin themelues ose në aktin e emërimit; në mungesë të përcaktimit të një afati, ata vazhdojnë në detyrë deri në revokim ose dorëheqje, dhe mund të rizgjidhen. Në rast së administratorët e ndërpresin detyrën për shkak të përfundimit të afatit, ata mbeten në detyrë deri në themelimin e organit të ri administrativ.

7. Asambleja mund t'i shfuqizojë administratorët për përgjegjësitë e parashikuara në nenin 2476 k.c.; shoqëria nuk i detyron asnjë dëmshpërblim administratorit të shfuqizuar pa arsye të drejtë, sepse pranimi i detyrës si administrator në këtë shoqëri nënkupton edhe pranimin e kësaj klauzole për të hequr dorë nga dëmshpërblimi.

8. Nëse mungon ndonjë nga administratorët, të tjerët marrin masa që ta zëvendësojnë përmes kooptimit: administratori ose administratorët e emëruar kështu qëndrojnë në detyrë deri në rinovimin e parë të organit administrativ. Nëse për ndonjë arsye Presidenti ose shumica e këshilltarëve e ndërpresin detyrën, të gjithë administratorët humbasin detyrën dhe duhet të pranohet vendimi i ortakëve për zëvendësimin e plotë të organit administrativ.

9. Administratorëve u takon rimbursimi i shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre.

10. Në aktin themelues ose me vendim të ortakëve, për çdo vit ushtrim







279  
280

aktiviteti, administratorëve mund t'u caktohet edhe një kompensim. Gjithashtu, mund t'u jepet edhe një shpërblim kur ndërpresin detyrën. Sa më sipër mund të jepet si pjesëmarrje në fitime ose si një shpërblim për rezultatet që kanë arritur njëri ose më shumë administratorë. Nëse nuk është përcaktuar kompensimi, nënkuptohet që administratorët kanë hequr dore prej tij.

[vula]  
[pullë takse]

#### **Neni 16) KËSHILLI ADMINISTRATIV**

1. Kur administrimi i është besuar një këshilli, ky zgjedh mes anëtarëve të vet një president, nëse nuk e ka bërë asambleja; mund të zgjedhë një zëvendës-president dhe mund të emërojë një sekretar që mund të mos ketë të bëjë me këshillin. Presidenti i këshillit administrativ verifikon rregullsinë e themelimit të këshillit, sigurohet për identitetin dhe ligjësinë e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e saj dhe sigurohet për rezultatet e votimeve.

2. Këshilli mblidhet, edhe në një vend tjetër të ndryshëm nga selia e shoqërisë, mjafton që të jetë në territorin e Bashkimit Evropian, çdo herë që presidenti e gjykon të nevojshme ose kur shumica e anëtarëve të tij bën kërkesë me shkrim.

3. Këshillin e thërret presidenti përmes një njoftimi që i dërgohet të gjithë administratorëve e kryetarëve, nëse janë emëruar, të paktën tetë ditë para dhe në rast urgjence, të paktën dy ditë pune para atij të vendosur për mbledhjen, me letër rekomande, apo me çdo lloj tjetër mjeti të përshtatshëm që siguron provën e marrjes.

4. Edhe pa një thirrje formale, këshilli administrativ është i themeluar në mënyrë të vlefshme dhe mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm të gjithë administratorët dhe nëse të gjithë kryetarët efektivë të emëruar, edhe pse jo të pranishëm, janë informuar për mbledhjen. Kjo nuk ndryshon faktin që çdo pjesëmarrës ka të drejtë të kundërshtojë diskutimin e argumenteve për të cilat mendon se nuk është informuar sa duhet.

[vula]  
[nënshkrimi]

5. Pranohet mundësia që mbledhjet e këshillit të mbahen përmes mjeteve të telekomunikacionit, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u lejohej të ndjekin diskutimin e të ndërhyjnë në kohë reale në trajtimin e argumenteve që trajtohen; nëse përmbushen këto kërkesa, këshilli konsiderohet i mbajtur në vendin ku gjendet presidenti dhe ku duhet të gjendet edhe sekretari, që procesverbal të hartohet e nënshkruhet në librin përkatës.

6. Vendimet e këshillit janë të vlefshme me praninë efektive të shumicës së anëtarëve të vet dhe ato janë marrë me shumicën absolute të votave të të pranishmëve. Në rast barazim votash, mbizotëron vota e Presidentit.

[nënshkrimi]

7. Procesverbal i vendimeve të këshillit administrativ duhet hartuar e nënshkruar menjëherë nga presidenti dhe sekretari. Procesverbal duhet të tregojë, edhe me dokumente të bashkëngjitura, identitetin e pjesëmarrësve, mënyrat dhe rezultatit e votimeve. Gjithashtu, duhet të lejojë, edhe me dokumente të bashkëngjitura, identifikimin e atyre që janë pro, abstenim ose kundër. Me kërkesë të administratorëve, në procesverbal duhen përmbledhur deklaratat e tyre në lidhje me rendin e ditën.

#### **Neni 17) ADMINISTRIM I PËRBASHKËT OSE VEÇMAS**

1. Me emërimin e më shumë administratorëve, në momentin e emërimit, kompetencat e administrimit mund t'u jepen atyre bashkërisht ose veçmas, ose disa kompetenca të administrimit mund të jepen në rrugë të përbashkët ose veçmas. Në mungesë të çfarëdolloj saktësisimi në aktin e emërimit në lidhje me mënyrat e ushtrimit të kompetencave administrative, këto kompetenca

[nënshkrimi]



kuptohet që u jepen administratorëve veçmas njëri-tjetrit.

2. Në rast administrimi më vete, secili administrator mund ta kundërshtojë operacionin që dëshiron të kryejë një administrator tjetër; ortakët, me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit aksionar, vendosin për kundërshtimin.

3. Për operacionet që duhen kryer në mënyrë të përbashkët, kërkohet miratimi unanim i të gjithë administratorëve, përveç rasteve kur është e nevojshme të veprohet me urgjencë për të shmangur një dëm për shoqërinë.

#### **Neni 18) KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV**

1. Organi administrativ menaxhon shoqërinë dhe kryen të gjitha veprimet e administrimit, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, të nevojshme për të përmbushur objektin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve për çështje që u takojnë vetëm ortakëve sipas nenit 10 të këtyre rregullave për funksionimin e shoqërisë. Megjithatë, gjatë emërimit mund të tregohen kufizimet e kompetencave të administratorëve. Nuk ndryshon fakti që hartimi i projektit të bilancit dhe i projekteve të shkrirjes e të ndarjes, si edhe vendimet për rritjen e kapitalit në përputhje me nenin 2481 kod. civ., janë në çdo rast kompetencë e organit administrativ.

2. Në rast emërimi të këshillit administrativ, ai mund të emërojë mes anëtarëve të vet një ose më shumë administratorë të deleguar ose një komitet ekzekutiv, duke përcaktuar detyrat përkatëse dhe shpërblimin. Nuk mund të delegohen çështjet e renditura në nenin 2381, pr.4, kod.civ.

3. Këshilli administrativ ose administratorët, në mënyrë të përbashkët ose veçmas, në varësi të sistemit të miratuar administrativ, mund të emërojnë edhe drejtorë, menaxherë ose përfaqësues me prokurë për të kryer aktet e caktuara apo kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat.

#### **Neni 19) PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

1. Shoqërinë e përfaqëson administratori unik.

2. Në rast të emërimit të këshillit administrativ, përfaqësimi i shoqërisë i takon presidentit të këshillit administrativ dhe këshilltarëve të deleguar individualë, nëse janë emëruar.

3. Në rast të emërimit të më shumë administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë u takon vetë atyre bashkërisht ose veçmas, në të njëjtën mënyrë si u janë dhënë kompetencat administrative në rastin e emërimit.

4. Përfaqësimi i shoqërisë u takon edhe drejtorëve dhe përfaqësuesve me prokurë, brenda kufijve të kompetencave që iu janë dhënë në aktin e emërimit.

#### **Neni 20) KONTROLLI LIGJOR I LLOGARIVE DHE KONTROLLI KONTABËL**

1. Shoqëria mund të emërojë kolegjin sindikal ose audituesin.

2. Në rastet e parashikuara nga neni 2477, pr. 2 e 3, kod. civ., emërimi i kolegjit sindikal është i detyrueshëm.

3. Kolegji sindikal është i përbërë nga tre anëtarë efektivë dhe nga dy zëvendës, të gjithë të shkruar në regjistrin e audituesve kontabël në Ministrinë e Drejtësisë. Presidentin e Kolegjit Sindikal e emërojnë ortakët me rastin e emërimit të vet Kolegjit. Ata qëndrojnë në detyrë për tre vjet, mund të rizgjidhen dhe ndërprerja e detyrës së tyre për shkak të përfundimit të afatit hyn në fuqi në momentin kur rithemelohet kolegji.

Ortakët e vendosin shpërblimin për kryetarët sipas tarifave të ekonomistëve.







4. Kolegji sindikal ose audituesi ushtrojnë funksionet e kontrollit kontabël të parashikuara nga neni 2409 ter. kod. civ.

5. Kur emërimi i kolegjit sindikal është i detyrueshëm sipas paragrafit 2 më sipër, kolegji sindikal monitoron edhe zbatimin e ligjit dhe të rregullave për funksionimin e shoqërisë, respektimin e parimeve e administrimit të duhur dhe veçanërisht përshtatshmërinë e rregullit organizativ, administrativ e kontabël të shoqërisë dhe funksionimin konkret të saj.

6. Kolegjin sindikal e thërret presidenti përmes një njoftimi të dërguar të paktën tetë ditë para dhe në rast urgjence, të paktën dy ditë pune para atij të vendosur për mbledhjen, me letër rekomande, apo me çdo lloj tjetër mjeti të përshtatshëm që siguron provën e marrjes.

Pranohet mundësia që mbledhjet e kolegjit të mbahen me mjete telekomunikacioni, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin e të ndërhyjnë në kohë reale në trajtimin e argumenteve që trajtohen; nëse përmbushen këto kërkesa, kolegji konsiderohet i mbajtur në vendin ku gjendet presidenti.

7. Nëse nuk rregullohen shprehimisht nga këto rregulla për funksionimin e shoqërisë, për kolegjin sindikal dhe audituesin zbatohen, rregullat e neneve 2397 e vijues, 2402 e 2409 bis e vijues të kod. civ.

#### **Neni 21) BILANCI DHE FITIMET**

1. Aktivitetet e shoqërisë mbylleen më 31 dhjetor të çdo viti; në fund të çdo aktiviteti vjetor, këshilli administrativ ose administratori unik bëjnë bilancin në përputhje me ligjin.

2. Bilancin duhet ta aprovojnë ortakët me vendim të marrë sipas nenit të mësipërm 10, brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e aktivitetit vjetor të shoqërisë, ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve kur ekzistojnë kushtet e parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit 2364:

në rastin e fundit, arsyet për shtyrjen e afatit administratorët duhet t'i raportojnë te relacioni i menaxhimit (ose te shënimet plotësuese, nëse bilanci është hartuar në formë të shkurtuar).

3. Pas tërheqjes së të paktën pesë përqind për rezervën ligjore, deri në masën një të pestën e kapitalit aksionar, fitimet neto do të ndahen mes ortakëve, përveç nëse asambleja vendos për tërheqje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme apo për një destinacion tjetër, ose vendos t'i kalojë të gjitha ose pjesërisht te vitet pasuese të aktivitetit.

4. Dividendët, që nuk janë mbledhur brenda pesë viteve nga dita që mund të kërkoheshin, i jepen shoqërisë.

#### **Neni 22) SHKRIRJA**

1. Shoqëria shkrihet për shkaqet që parashikon ligji.

2. Asambleja do të vendosë mënyrën e likuidimit dhe do të emërojë një ose më shumë likuidues duke iu treguar kompetencat dhe shpërblimin.

#### **Neni 23) KLAUZOLA E ARBITRAZHIT**

1 Çdo lloj mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin dhe me ekzekutimin e këtyre rregullave për funksionimin e shoqërisë, apo për çfarëdolloj çështje tjetër që ka të bëjë drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë me marrëdhëniet e shoqërisë, ortakëve, apo mes ortakëve dhe shoqërisë, administratorëve të vet, likuiduesve, do t'i caktohet një kolegji arbitror.

Kolegji arbitror përbëhet nga 4 arbitra hartues miqësorë të emëruar të gjithë

[vula]  
[pullë takse]

[vula]  
[nënshkrimi]

[nënshkrimi]





nga presidenti i urdhrorit të ekonomistëve të Monzës, brenda tridhjetë ditësh nga kërkesa e palës më të zellshme. Arbitrat e emëruar kështu do të caktojnë presidentin e kolegjit arbitror. Selia e kolegjit arbitror do të ndodhet në vendbanimin e presidentit të kolegjit arbitror.

2. Kolegji arbitror do të vendosë, në mënyrë të paanshme dhe pa formalitet procedural, me shumicë brenda nëntëdhjetë ditësh nga themelimi i vet dhe vendimi i tij do të jetë përfundimtar.

3. Kolegji arbitror do të vendosë si të ndahen shpenzimet e arbitrazhit mes palëve.

4. Për sa nuk është parashikuar, zbatohen dispozitat e dekretit legjislativ nr. 5 të 17 janarit 2003.


5. Anulimi i kësaj klauzole arbitrazhi duhet të miratohet me vendim të ortakëve, me shumicën e të paktën dy të tretave të kapitalit aksionar. Ortakët që mungojnë apo që nuk janë dakord, brenda nëntëdhjetë ditëve të ardhshme, mund të ushtrojnë të drejtën e tërheqjes sipas nenit 9.

6. Ndryshimet në përmbajtjen e kësaj klauzole arbitrazhi duhen miratuar me vendim të ortakëve, me shumicën që parashikohet për asamblenë e jashtëzakonshme.

Bashkëngjitur

Milano, 23 shtator 2004

Massimo Boldrocchi



[nënshkrimi]

ANO  
★  
TI





**KOPJE E KRAHASUAR NGA ROSA RUBINO**

SHËNIM KONTABËL

Dëftesë pagese \_\_\_\_\_ 333 \_\_\_\_\_ më datë 15-01-2020

Kërkesë: Nr. 1 kopje, me stemë, prej 16 faqesh (Bashkëngjitur aktit)

**Totali i arkëtuar me dëftesë pagese: 141,75 €**  
**(Euro njëqindedyzetnjë / 75)**

nga të cilat € 64 (Euro gjashtëdhjetë e katër / 00) si taksë me pullë të paguar në mënyrë virtuale sipas dekretit nr. 3/2591/97 të 7 marsit 1997.

Dëftesë pagese shtesë Nr. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_


TOTALI € \_\_\_\_\_

nga të cilat \_\_\_\_\_ € si taksë me pullë të paguar në mënyrë virtuale sipas dekretit nr. 3/2591/97 të 7 marsit 1997.

CERTIFIKIM PËRPUTHSHMËRIE

**MINISTRIA E DREJTËSISË – Arkivi Noterial i Milanos**

Kjo fotokopje, e përbërë nga Nr. 16 faqe, përputhet me shtojcën A të aktit të regjistrit Nr. 93494 dhe dosje Nr. 19514 më datë 23.9.2004, i regjistruar në Milano më 7.10.2004 me numër 102721, që ruhet në këtë Arkiv Noterial mes akteve të Noterit në Milano, Dr. CHIODI DAELLI CESARE.



Milano, sot 16 janar 2020

**RUAJTËSI I DELEGUAR**  
(Dr. Marina BOZZA)  
[nënshkrimi]

[vula]

1000

1000





N. ISCRIZIONE  
Enrolment no.  
10047

**TRIBUNALE ORDINARIO DI MILANO**  
**ORDINARY COURT OF MILAN**

**Verbale di giuramento traduzione stragiudiziale**  
**Sworn Statement of out-of-court Translation**

Modulo per traduttori iscritti all'Albo  
Form for Translators enrolled with the Register of the Court of Milan

Traduttore iscritto all'Albo di MILANO  
In data 18/02/2020, nella Cancelleria del Tribunale Ordinario di Milano, avanti al sottoscritto Cancelliere è personalmente comparso/a il/la Signor/a Cristina Bocchi, nato/a a Legnano il 21/01/1963 residente in Milano prov. ( ) identificato/a con documento C.I. CA59180CP, rilasciato/a da Comune di Milano il 5/11/18 iscritto/a nell'Albo dei Traduttori del Tribunale di MILANO al n. 10047 per la/le lingua/e arabo, francese, inglese, tedesco e spagnolo il/la quale esibisce la traduzione dalla lingua italiana alla lingua albanese da lui/lei effettuata in data 17/02/2020 e chiede di poterla asseverare con giuramento ai sensi di legge.  
Dichiara, altresì, che il documento tradotto è copia conforme.  
Ammonito/a ai sensi dell'art. 193 c.p.c. e dall'art. 483 c.p. l'a comparante presta il giuramento ripetendo le parole: "Giuro di aver bene e fedelmente proceduto alle operazioni e di non aver avuto altro scopo che quello di far conoscere la verità".  
Si raccoglie il presente giuramento di traduzione stragiudiziale per gli usi consentiti dalla legge<sup>2</sup>.

Letto, confermato e sottoscritto.

Il/la Dichiarante

Cristina Bocchi



Translator enrolled with the Register of MILAN  
On 18/02/2020 the following person appeared in person before the undersigned Clerk in the Clerk's Office of the Ordinary Court of Milan, Mr/Ms Cristina Bocchi, born in Legnano on 21/01/1963 and residing in Milano identified by means of C.I. CA59180CP issued by City of Milano on 5/11/18 enrolled with the Translators' Register of MILAN Court under no. 10047 for the Arabic, French, English, German and Spanish language(s), and produced the translation from the Italian language into the Albanian language, done by him/her on 17/02/2020 and asked to be allowed to swear it in compliance with the law.

He/she further declares that the translated document is certified copy.

The appearing party, having been warned in accordance with art. 193 of the Code of Civil Procedure and art. 483 of the Penal Code<sup>(1)</sup>, hereby swears by repeating the following words: "I swear that I have done the translation accurately and faithfully and that my sole purpose was to disclose the truth".


This oath for an out-of-court translation is taken for all legal purposes<sup>(2)</sup>.

Read, confirmed and signed.

The Declarant

Cristina Bocchi

UFFICIO AMMINISTRATIVO  
Dott. Rosario AZZARELLI



TRIB. MI URP 18/02/20 N. 6223

N.B.: L'ufficio non assume alcuna responsabilità per quanto riguarda il contenuto della traduzione asseverata con il giuramento di cui sopra.  
This Office assumes no responsibility for the contents of the translation sworn under oath as set out above.

002377

# APOSTILLE

(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)

Paese **ITALIA**

Il presente atto pubblico

2. è stato sottoscritto da

*AZZAROLI ROSSANO*

3. agente in qualità di ..... FUNZIONARIO.....

4. e segnato dal contrassegno/timbro di .....

..... SIGILLO DI STATO .....

Attestato

**18 FEB 2020**

5. a Milano..... 6. il .....

7. dall'ufficio del pubblico ministero .....

sotto il numero *2377* .....

8. contrassegno/timbro ..... SIGILLO DI STATO.....

10. Firma  
*Rm*



**Il Sost. Procuratore della Repubblica**  
Dr.ssa Rossana GUARESCHI



GJYKATA E ZAKONSHME E MILANOS

Nr. Prot.

10047

Procesverbali i betimit të përkthimit jashtë gjykatës

Formulari për përkthyesit e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës së Milanos

Përkthyesi i regjistruar në Regjistrin e Milanos

Më 18.2.2020 në Regjistrin e Gjykatës së zakonshme të Milanos, u paraqit personalisht përpara kancelarit të nënshkruar znj. Cristina Bocchi, e lindur në Legnano më 21/01/1963, me banim në Milano, e identifikuar me dokumentin ID: CA59180CP, lëshuar nga Komuna e Milanos më 5/11/18, e regjistruar në Regjistrin e përkthyesve të Gjykatës së Milanos me nr. 10047, për gjuhët arabe, frënge, angleze, gjermane dhe spanjolle, e cila tregon përkthimin nga gjuha italiane në gjuhën shqipe të bërë prej saj në 17.02.2020 dhe kërkon që të lejohet të kryejë betimin në përputhje me ligjin.

Deklaron gjithashtu se dokumenti i përkthyer është kopje e certifikuar.

Në bazë të nenit 193 të Kodit të procedurës civile dhe nenit 483 të Kodit Penal Italian<sup>1</sup>, personi i paraqitur bën betimin duke përsëritur fjalët: “Beto hem se kam kryer mirë dhe me besnikëri përkthimin dhe se nuk kam pasur qëllim tjetër përveç se të bëj të njohur të vërtetën.

Ky betim për përkthim jashtë gjykatës jepet për të gjitha përdorimet e lejuara me ligj.

Lexuar, konfirmuar dhe nënshkruar.

Deklaruesi/ja



Drejtori administrativ

Dok. Rosario Azzarelli

vulë

Shënim: Zyra nuk merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e përkthimit të betuar me betimin e përmendur më lart.

<sup>1</sup>Mashtrimi i kryer nga një person privat në një akt publik.

<sup>2</sup>R.D. 1366/1992; D.P.R. 396/2000; D.P.R. 445/2000;

NOV 1954  
TIRAH

FEDERAL BUREAU OF INVESTIGATION  
NOV 1954  
TIRAH



002377

**APOSTILE**

(Konventa e Hages e 5 tetorit 1961)

Vendi

ITALI

Ky dokument zyrtar:

2. është nënshkruar nga ..... Azzarelli Rosario.....

3. Në cilësinë e.....FUKSIONARIT.....

4. mban vulën/pullën e .....

.....VULA E SHTETIT.....

Vërtetuar

5. Në MILANO..... 6. Më..... **18 SHKURT 2020**.....

7. nga Zyra e ministrisë publike

8. me numër 2377

9. vulën/pullën \_\_\_\_\_ VULA E SHTETIT \_\_\_\_\_

10. {nënshkrimi}

Prokurori Zëv. i Republikës  
Dr. Rossano GUARESCHI-

[vula]

*Perkleu*



VËRTETIM NËNSHKRIMI

DHOMA E NOTERISË TIRANË

NO. 2063 REP

VËRTETIM  
NËNSHKRIM PËRKTHIMI

Në Tiranë, sot më 02.06.2020 (dymijë e njëzetë), prej meje noterit publik, Anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, vërtetohet firma e përkthyeses së autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për përkthimin zyrtar të gjuhës italiane, Znj. Annamaria Xhuli, lindur më 26.04.1986, Tiranë, ID Nr. 031614523 dhe numër personal I65426071Q, e cila përktheu dokumentin bashkëlidhur nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi atë sipas rregullave.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 "Për noterinë" datë 20.12.2018, vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.

ATTESTATO DI FIRMA

CAMERA NOTARILE TIRANA

NR REP. 2063

ATTESTATO  
ATTESTATO DI TRADUZIONE

NOTER

Oggi a Tirana, li 02.06 2020 (duemila venti), da me Pubblico Notaio, Membro della Camera Notarile di Tirana, si attesta tramite il presente documento la firma del traduttore autorizzato dal Ministero di Giustizia la traduzione ufficiale in lingua italiana, la Sig.ra Annamaria Xhuli, nata il 26.04.1986, a Tirana, in possesso della carda d'identità nr. 031614523 e avente come codice personale il nr. I65426071Q, la quale ha tradotto dalla lingua italiana alla lingua albanese e sottoscritto il documento allegato.

Per quanto sopra, in virtù della Legge nr. 110/2018 'Per i Notai', data 20.12.2018, accerto tramite il presente documento la firma del traduttore.

NOTAIO

